Kanë përparuar muferridunët!

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "Teksa i Dërguari i Allahut po ecte rrugës për në Mekë, kaloi pranë një kodre që quhej Xhumdan dhe tha: 'Ecni, se ky është Xhumdani! Kanë përparuar muferridunët!' - Cilët janë muferridunët, o i Dërguari i Allahut? - pyetën ata. - 'Ata burra dhe ato gra që e përmendin Allahun shumë', - tha Pejgamberi ."

[Sahih] [Transmeton Muslimi]

Profeti në këtë hadith sqaroi pozitën e atyre që e përmendin shpesh Allahun dhe se ata janë veçuar duke u paraprirë të tjerëve në arritjen e shkallëve më të larta në Xhenetet e mirësisë, si dhe i krahasoi me kodrën Xhumdan, e cila dallon nga kodrat e tjera.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/3719